



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Europian”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Eglantina Gjermeni, Xhemal Qefalia, Ilir Xhakolli, Bashkim Fino dhe Evis Kushi

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjasha, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari dhe Edmond Panariti

Të ftuar:

Rovena Voda -Zëvendësministre e Brendshme

Alma Mehmeti - Shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Brendshme

Silvana Dervishi - Specialiste në Ministrinë e Brendshme

Ilir Bejko - Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Mimi Kodheli – Kalojmë te shqyrtimi i projektligjit, për të cilin është përgjegjëse Ministria e Brendshme. Të pranishme kemi zëvendësministren Voda. Mirë se erdhët!

Projektligji i parë është “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit European”.

Zonja Voda, shkurtimisht për projektligjin e parë dhe më pas kalojmë te projektligji i dytë. Kalojmë te pyetjet dhe diskutimet nëse kolegët kanë, pastaj kalojmë në votim.

Zonja zëvendësministre, fjala për ju!

Rovena Voda - Përshëndetje të gjithëve!

Për sa i përket ratifikimit të memorandumit të parë të mirëkuptimit, i cili ndryshon memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit European, në fakt, është një projektakt që, megjithëse nuk është i planifikuar në programin analitik të akteve për vitin 2018, është një projektakt shumë i rëndësishëm, i cili vjen në linjë me prioritetet e qeverisë shqiptare, por edhe të Ministrisë së Brendshme, kryesisht në fushën e luftës kundër drogave. Ky ka qenë një memorandum i nënshkruar fillimisht me Ministrinë e Drejtësisë, pasi komponentët kryesorë të saj janë komponentë që i përkasin kësaj ministrie, kryesisht fusha e bashkëpunimit gjyqësor, por kemi edhe një komponent D, ku përgjegjëse është Ministria e Brendshme. Prandaj ne vijmë me ndryshimin e këtij memorandumi, ku Ministria e Brendshme do të asistohet me ndihmë financiare nga Komisioni European në shumën 6 mijë euro për çdo vit të kësaj asistence, pra të kohështirjes së këtij memorandumi për sa i përket përmirësimit të politikës në fushën penale, në luftën kundër drogave, por edhe të bashkëpunimit policor. Mbështetja është shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh që jemi para procesit të përgatitjes të hapjes së negociatave. Këtu përmendim procesin *prescreening*, që fillon në nëntor, me kapitullin 24, ku përgjegjëse është Ministria e Brendshme. Besoj se vjen si një vlerë e shtuar në kuadër të realizimit të prioriteteve të Ministrisë së Brendshme. Kaq kisha për sa i përket memorandumit të parë.

Mimi Kodheli – Kur është firmosur memorandumi midis Ministrisë Drejtësisë dhe BE-së?

Rovena Voda – Është firmosur më 28 shtator 2016.

Mimi Kodheli – Pse nuk është involvuar Ministria e Brendshme, që në atë kohë?

Rovena Voda – Komponenti D, që i përket Ministrisë së Brendshme është shtuar më vonë si komponent, pjesë e këtij memorandumit.

Mimi Kodheli - A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Unë mendoj se rikualifikimi i memorandumit bazuar në një marrëveshje të re midis Republikës së Shqipërisë, duke pasur parasysh komponentin D, dhe Bashkimit European, është i një rëndësie të veçantë, kështu që nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta miratojmë projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumit e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit European”.

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Eglantina Gjermeni, Xhemal Qefalia, Ilir Xhakolli, Bashkim Fino, Evis Kushi

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Alma Mehmeti - Shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Brendshme

Silvana Dervishi - Specialiste në Ministrinë e Brendshme

Shpresa Shahaj - Përgjegjëse Sektorit në Drejtorinë e Traktateve dhe Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Migena Baholli - Specialiste në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Mimi Kodheli - Kalojmë te diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Urdhëroni, zonja Zëvendësministre!

Rovena Voda – Mendoj se projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)” për të vendosur një standard tregon qartë vullnetin e qeverisë shqiptare në respektimin të drejtave të njeriut, duke mundësuar, nëpërmjet këtij projektligji, gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste, pra gjatë periudhës së diktaturës.

Mendoj se Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur është agjencia e vetme ndërkombëtare, e cila ka ekspertizën e duhur në fushën e gjetjes së personave të zhdukur për shkak të konflikteve, pra të luftës, të rasteve të zhdukjeve me forcë apo edhe të rasteve të fatkeqësive natyrore. Unë besoj se ishte momenti për qeverinë shqiptare që ta miratonte këtë projektligj. Dua të them se fillesat i ka që në vitin 2014, me nënshkrimin e një deklarate të qeverisë shqiptare me ICMP-në, është nënshkruar nga ish-ministri i Mirëqenies Sociale, ku është bërë njëlloj zotimi i qeverisë shqiptare për të ndërmarrë përballjen me të kaluarën, përballjen me atë regjim, për të vendosur një standard të të drejtave të njeriut, për të ndihmuar familjarët e viktimave të asaj kohe, eshtrat e të cilëve nuk gjenden.

Më vjen mirë të them se më në fund edhe Republika e Shqipërisë firmos këtë projektligj me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, pasi pothuajse të gjitha vendet e rajonit kanë një marrëveshje të tillë të nënshkruar me ICMP-në. Ashtu siç e përmenda dhe pak më parë, nëse më lejoni të bëj pak histori, ICMP-ja është agjencia e vetme e specializuar për këtë gjë. Në fakt, është krijuar me iniciativën e presidentit amerikan, Bill Clinton, në vitin 1996, pas samitit të G7. Sigurisht, fillesën e mori nga ngjarjet makabre të ndodhura në Bosnjë Hercegovinë për shkak të konfliktit të atëhershëm dhe numrit të madh të të vrarëve dhe, pikërisht, faktit që shumë eshtra të këtyre personave nuk gjendeshin. Ne shpresojmë që, nëpërmjet këtij projektligji, qeveria shqiptare tashmë me një hap konkret dhe shumë të rëndësishëm, të përballemi me të kaluarën e asaj kohe.

Zonja kryetare, dua të shtoj edhe diçka, në fakt, jo vetëm deri në vitin 1991 ne kemi persona të zhdukur për shkak të regjimit të asaj kohe, por ky fenomen, në fakt, është një plagë e shoqërisë shqiptare edhe pas viteve ’90 sepse kemi persona të zhdukur për shkaqe të ndryshe. Në fakt, ne si grup negociator në momentin që kemi negociuar këtë marrëveshje me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, kemi menduar që të lëmë një hapësirë edhe

për raste të tjera. Pra, të mundemi të ndihmojmë apo të shërojmë plagët e familjeve shqiptare, edhe pas viteve '90, për rastet e personave të zhdukur.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Kur quhet problematik si fenomen ky i njerëzve të zhdukur, kur ndodh 1 në 10 mijë banorë, apo zero në 10 mijë banorë, që ta dimë edhe ne, a e kemi problem apo po flasim për një çështje... Çështjen e regjimit, po e marrim të mirëqenë, se ishte diktaturë. Tani, me statistika, kur quhet problem zhdukja e njerëzve? Sa të zhdukur në 1000 banorë? Sa në 10 mijë banorë? Të paktën, si ekonomist, unë kështu e di.

Mimi Kodheli – Kisha një pyetje, në vazhdim të kësaj që thotë edhe zoti Bushati. Për sa persona flitet pak a shumë? Cili është numri i personave të zhdukur, duke pasur parasysh të zhdukurit në kohën e komunizmit dhe se çfarë ka ndodhur më tej?

Po, zonja zëvendësministre.

Rovena Voda – Faleminderit për ndjeshmërinë që sollët në këtë komision!

Nuk është problematikë, se u tha problematikë. Për mua, çdo jetë e humbur ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli - Të lutem, numrin! Pa komente.

Rovena Voda – Deri tani kemi 691 individë të deklaruar të zhdukur, të humbur, nga Policia e Shtetit, nga të cilët 26 persona janë të moshës deri në 14 vjeç, 14 persona deri në 18 vjeç....

Mimi Kodheli - Të lutem, këto janë të dhëna mbas '90-s.

Rovena Voda - Po. Nga viti 1990 deri në këtë moment, pra në 27 vjet.

Mimi Kodheli – Po për periudhën para viteve '90?

Rovena Voda – Flitet për 4 mijë e ca persona, të cilëve nuk u gjenden eshtrat.

Mimi Kodheli – E konsiderueshme.

Rovena Voda – Më pas kemi të zhdukurit mbi 18 vjeç, që janë 605.

Ervin Bushati – Këta janë të emigracionit apo në Shqipëri?

Rovena Voda - Unë flas për shtetasit shqiptarë, që në statistikat e Policisë së Shtetit rezultojnë të zhdukur.

Ervin Bushati – Jo i mbytur, për shembull.

Rovena Voda – Zhdukja mund të ketë disa forma, mund të ketë disa shkaqe. Pra, nuk ka eshtra. Mund të jetë i mbytur për shkak të emigracionit të paligjshëm e të tjerë... Është e drejtë edhe kjo që konstatoni ju.

Mimi Kodheli – Nuk ka vend ku të prehet.

Rovena Voda – Po, kjo është.

Mimi Kodheli – Faleminderit! Ka pyetje dhe diskutime të tjera?

Kisha edhe një pyetje, zonja zëvendësministre. Ratifikim i kësaj marrëveshjeje, e ka të nevojshme të shoqërohet me një shtim të buxhetit? Në rregull, e ratifikuam marrëveshjen, por ne duhet të marrim disa aksione bazuar në ligje, të cilat kanë disa shpenzime.

Rovena Voda – Faleminderit për pyetjen, zonja kryetare!

Siç e përmenda në fillim, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur është agjencia që ka gjithë ekspertizën e duhur. Në fakt, i gjithë ky proces do të fillojë me një financim shumë të madh të Komisionit Europian. Në momentin kur është nënshkruar kjo marrëveshje, në event ka qenë prezent edhe ambasadorja e delegacionit të BE-së në atë kohë, zonja Vlahutin. ICMP-ja do të financohet me një shumë prej 600 mijë eurosh, pra nuk janë kosto të buxhetit të shtetit. Në bashkëpunim me institucionet shqiptare, sigurisht, brenda burimeve njerëzore që ka, pa kosto shtesë, ICMP-ja do të bashkëpunojë me shkëmbime informacioni apo për të qenë në vendngjarje kur të jetë e nevojshme, pra duke respektuar, po themi, procedurat e zhvarrimit, të marrjes së mostrave të ADN-së e të tjerë. Të gjitha shpenzimet, përfshirë edhe testet e ADN-së, që janë shumë të kushtueshme, do të bëhen nga ICMP-ja, jo nga shteti shqiptar.

Bashkim Fino – Kryetare, e di se çfarë miratojmë ne? Ne miratojmë statusin diplomatik të zyrës që hapet këtu. Kaq. Pjesa tjetër është... Shumë mirë që e bëtë këtë pyetje dhe shumë mirë që në përgjithësi zëvendësministrja “të shkatërron” me përgjigje, por ne miratojmë statusin diplomatik të zyrës që hapet këtu. Prandaj janë këtu edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme. Pra, ne miratojmë atë status. Kjo është tamam e linjës suaj. Ju jeni komision përgjegjës dhe duhet ta votoni. Pastaj, pyetjet e tjera financiare janë...

Ervin Bushati – Mund të bëj një sqarim?

Bashkim Fino – E ke lexuar projektligjin? Po miratojmë statusin diplomatik të një punonjësi që do të ketë një zyrë në Tiranë. Mos jam gabim?

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Fino! Zoti Bushati...

Ervin Bushati – Çdo gjë është në kontekst, edhe ne nuk mblidhemi kot. Po kalojmë edhe buxhetin. Ju do të vini prapë për buxhetin. Ne ekonomistët mund të dukemi pak si robotikë kur flasim, por parametrat dhe indekset prandaj kanë dalë dhe kur kërkohet që sa në 10 mijë banorë janë zhdukur ose sa nga këta persona quhen... Se këtu mund të ketë edhe të medias dhe mund të dalin e të thonë se na dalka një problem i tillë, ndërkohë që statistikat nuk e tregojnë këtë. Për shembull, në Amerikë kishin bërë një studim dhe dilte që nga 11 shtatori e deri tani

janë vrarë 170 vetë prej terrorizimit dhe janë harxhuar një trilion dollarë, ndërkohë që në vit vdesin 49 mijë vetë nga opioidet dhe nuk është harxhuar asnjë lek. Domethënë, në fund të ditës, edhe ne do të duam të dimë se çfarë balance ekonomike t'i vëmë kësaj dhe se çfarë quhet problematikë në raport, prandaj janë indekset. Këtë desha të sqaroja.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Kryetare, jam në një linjë me Bushatin. Nuk diskutohet që kjo është çështje e punës së përditshme dhe duhet të ketë një zyrë për të gjitha të dhënat që ky kërkon. Kjo është shumë e vërtetë. Për të hequr pak lodhjen e zotit Bushati, sepse është edhe anëtar i Komsionit të Ekonomisë dhe ka shumë lodhje, që të na lërë edhe ne më shumë kohë për të lexuar buxhetin, për të bërë ndonjë vërejtje për të... Çfarë miratojmë ne? Ne miratojmë një marrëveshje: të ngrihet zyra me një status diplomatik të caktuar. Gjithë të tjerat vijnë më pas.

Mimi Kodheli – Në respekt të statusit që duhet t'i japim zyrës dhe të Konventës së Vjenës, unë mendoj që është koha për ta hedhur në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zonja Zëvendësministre dhe zonjave që ju shoqërojnë!

(Diskutime pa mikrofon)

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Datë 05. 11. 2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Ervin Bushati, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Eglantina Gjermeni, Xhemal Qefalia, Ilir Xhakolli, Bashkim Fino, Evis Kushi.

Mungojnë: Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti.

Të ftuar:

Ilir Halilaj - Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Pjerin Shoshi - Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango - Drejtore Juridike

Elma Vathi - Shefe Sektori i Koordinimit dhe Integritetit

Mimi Kodheli - Kolegë, e kuptoj lodhjen tuaj, por duhet të vazhdojmë me diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në komisionin tonë zoti Halilaj, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i shoqëruar edhe nga zoti Shoshi dhe zonjat Llango dhe Vathi. Mirë se keni ardhur!

Zoti Zëvendësministër, fjala është për ju për të prezantuar shumë shkurt marrëveshjen dhe arsyet pse keni ardhur për ta ratifikuar.

Ilir Halilaj - Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar anëtarë,

E nderuar zonja kryetare,

Jemi këtu për të kërkuar mbështetjen tuaj për miratimin në parim të marrëveshjes midis Republikës së Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për fondin e garancisë prej 5 milionë eurosh në shërbim të financimit të sektorit bujqësor dhe të agropërpunimit.

Kjo marrëveshje vjen pas një eksperience të mirë. Në tre vjetët e fundit, nga viti 2013 deri në vitin 2017, një fond i ngjashëm prej 3 milionë eurosh, financim i Bashkimit European, ka shërbyer për garantimin e kreditimit të rreth 1 mijë subjekteve në agropërpunim dhe në bujqësi dhe ka realizuar në 90% të saj disbursimin e këtij fondi.

Kjo marrëveshje, gjithashtu, është një instrument shtesë që ne kemi në këtë fazë të implementimit të IPA-s për zhvillimin rural, rreth 94 milionë euro bashkëfinancim i qeverisë shqiptare dhe Bashkimit European për grantet në bujqësi, thirrja për të cilin pritet të hapet në fund të muajit nëntor.

Këtu kam ardhur së bashku me kolegët për t’iu përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni për këtë marrëveshje dhe për të marrë parasysh çdo sugjerim tuajin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Unë di që ka pasur disa pretendime serioze nga deputeti Fino për përmbajtjen dhe objektivat e marrëveshjes, të mbërritura dhe të pa mbërritura.

Personalisht, marr e para të drejtën e diskutimit për këtë projektligj. Shikoj që afati për lidhjen e kontratave për përdorimin e shumës së financimit është përcaktuar deri në datën 31 dhjetor dhe më rezulton e vështirë të realizohet. Më falni për skepticizmin.

Pse KfW-ja përjashtohet nga të gjitha taksat dhe tatimet publike? Ka vështirësi në zbatimin e kredidhënies dhe për pasojë të kredimarrjes në këtë segment. Unë besoj se kjo ndodh edhe për shkak të copëzimit që i bëhet pronës në sektorin bujqësor. Pra, çfarë do të ndodhë nëse prona do të vazhdojë të jetë e copëzuar dhe fermerët nuk do të bien dakord për t'u bashkuar? Do të thotë se do të vazhdoni me mospushtet në këtë projekt. Ka një njeri që diskuton seriozisht lidhur me një qasje ndryshe, për aq kohë sa kemi shumë vite që eksperimentojmë në këtë fushë, harxhohen shumë para dhe rezultatet nuk janë atje ku duhet të ishin.

(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)

E dëgjojmë zëvendësministrin?

Fjala është për ju.

Ilir Halilaj – Faleminderit për pyetjet!

Po e filloj nga pyetja e fundit, që ka të bëjë me mundësitë e absorbimit ose kapacitetet e absorbimit që ka bujqësia shqiptare për kreditim. Ky lloj instrumenti presupozohet të adresojë pikërisht ngërçin që kanë, në fakt, institucionet financiare për të kredituar sektorin bujqësor për shkak të copëzimit ose të fragmentarizimit që kanë. Fermeri i sotëm e ka të vështirë të kolateralizojë asetet e tij. Zakonisht moskolateralizimi rezulton në kredi me interesa tepër të larta, ndërkohë që ky si fond garancie u shërben bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve të mikrofinancës për të mitiguar riskun, që bankat kanë në kreditimin e sektorit. Pra, kjo ia bën bujqësisë më të lehtë aksesin në financë në situatën që jemi.

Ndërkohë, për sa i përket periudhës së kreditimit, është edhe një modifikim që e kemi marrë parasysh nga komentet në Komisionin e Ligjeve më herët sot, që brenda datës 31.12.2018 duhet të kryhet disbursimi i fondeve nga pala gjermane, domethënë jo kreditimi i tyre në sektorin bujqësor. Pra, kreditimi i tyre në sektorin bujqësor ose injektimi në sektorin bujqësor të këtyre fondeve do të kryhet në vitet në vazhdim.

Mimi Kodheli – Ju shkoni me shpresën se deri në fund të dhjetorit 2018 pala gjermane do të disbursohet?

Ilir Halilaj – Do të disbursojë fondet në entitetin e krijuar për menaxhimin e këtyre fondeve.

Mimi Kodheli – Jashtë llogarive shtetërore.

Ilir Halilaj – Po, dhe është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, ku Ministria e Bujqësisë ka një përfaqësi që do të presë këto fonde. Pastaj, në bazë të marrëveshjeve me institucionet financiare do të kryejë disbursimin e tyre, sipas nevojave që këto institucione financiare paraqesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – PIU?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Halilaj – Kjo funksionon si një organizatë jofitimprurëse, ka statut të miratuar në gjykatë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Dakord.

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Po e sjell edhe këtu çështjen që kam ngritur te Komisioni i Ligjeve, sepse duhet të ngelet në procesverbal dhe duhet ta korrigjojnë, siç kemi rënë dakord. Problemi është që ky është grant 5-milionësh, që ia jep KfW-ja gjermane ministrisë përkatëse, e cila...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky 5-milionësh është grant. Në periudhën 2014-2017 ka dhënë 3 milionë, i pari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pastaj 3-milionëshin e kanë ndarë për rreth njëmijë, le të themi, fermerë ose ndërmarrje të vogla të mesme, kështu quhen, ndërkohë që ky i dyti kërkon nja dymijë-tremijë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pati pyetje në komision, që e kam bërë unë, dhe kështu e mora përgjigjen: “Dymijë-tremijë fermerë ose ndërmarrje të vogla të mesme që mund të financohen”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në relacion, zonja kryetare, është shënuar që KfW-ja hiqet nga taksat, pra nga TVSH-ja dhe taksa të tjera të ngjashme. Pyetja që bëmë ne dhe sqarimi që i dhamë zëvendësministrit, po e them edhe këtu, është që në relacion të thuhet shqip, saktë dhe shkoqur se cilat taksa nuk paguhen, pra nga cilat taksa përjashtohet.

Taksat në Republikën e Shqipërisë janë disa, të cilat ne i kemi miratuar me ligj, pra ne nuk kemi miratuar vetëm taksën e TVSH-së e të tjerë, por kemi thënë shprehimisht: “taksa e TVSH-së, taksa mbi tokën, taksa”, ku e di unë, “e biznesit të vogël, ajo taksë, kjo taksë”, pra ka disa lloj taksash, ku disa janë të pushtetit vendor, disa të tjera janë taksa qendrore, të cilat i kemi miratuar. Kjo do të thotë se duhet vendosur edhe në relacion se nga cilat taksa përjashtohet KfW-ja, me emër dhe mbiemër të plotë, jo siç është lënë në relacion, madje në draftin që kanë paraqitur këta ose në marrëveshjen që kanë firmosur, e kanë firmosur *mot à mot*, siç them unë.

Tjetër herë duhet të korrigjohen, të rregullohen dhe të shkruhen tamam gjërat kur firmoset një gjë. Kjo është shumë e rëndësishme!

Tjetër aspekt i rëndësishëm është që ne duhet ta monitorojmë këtë projekt. Monitorimi i këtij projekti është që ne e votojmë, kalon, këta mund të lidhin marrëveshje, siç tha zëvendësministri këtu, brenda 31 dhjetorit dhe ta kapin datën e fundit ndërmjet ministrisë dhe KfW-së gjermane. Por imagjinoni që pastaj do të lidhen edhe shumë marrëveshje të tjera me të gjithë kreditorët e tjerë të vegjël, ndërmarrjet e vogla të mesme dhe janë rreth 5 milionë euro që duhet të ndiqen dhe të shikohen.

Ajo që ka më shumë rëndësi për ne nuk është thjesht të ngremë dorën për një marrëveshje, por se ku do të shkojnë këto para, si do të shkojnë këto para, në çfarë rrjeti në Shqipëri do të shkojnë këto para, në çfarë qarqesh dhe si do të përfundojnë, se mund të mos përfundojnë në qarqet e caktuara, e të mos përfundojnë në qarqet jo të caktuara. Domethënë, e gjithë Shqipëria duhet të marrë nga këto fonde.

Çështja e fundit që kam, meqenëse ju, siç e thatë që në fillim se keni mbaruar degën “Financë”, e kam thënë në Komisionin e Ligjeve, po e them edhe këtu, madje përfitoj nga rasti që jeni ju dhe të paktën më kuptoni, se atje në komisionin ku jam, nuk më kupton Ulsi, jo për fajin e tij, por për fajin tim, se ai është jurist, ndërsa unë ekonomist me diplomë, grantet nuk duhet të miratohen asnjëherë në parlament. Grantet miratohen me shkresë, me vendim të qeverisë ose të vetë ministrit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Granti nënkupton se unë dua dhe të jap ty. Kam dëshirë të them se të jap 5 milionë. E pse duhet të vijë tani në parlament 140 veta, burra e gra, të na bëjnë vizitë dhe të thonë: votoni ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...këtë grantin që na e jep KfW-ja dhe na e jep falas!

Në parlament, zotërinj, megjithëse jam ekonomist, votohen vetëm kreditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse? Kredia votohet, sepse e paguajmë ne, fëmijët tanë brez pas brezi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taksën ose sa do të paguash ti çdo muaj.

Mimi Kodheli – Nuk besoj se këtu vjen vetëm për taksën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ndërsa granti nuk është dhënë kredi. Grantin ta jep qeveria. Unë u kam dhënë votëbesimin Kryeministrit dhe ministrit. Ministri, sipas Kushtetutës ka për detyrë të bëjë detyrën e vet. Që të bëjë detyrën e vet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për taksën le të vijë, por jo për grantin, se unë nuk kam punë me të dhe nuk kam asnjë lloj merak. Ne kemi miratuar edhe grante me vlerë 100 mijë euro. Të paktën, ky i sotmi është me një shumë të konsiderueshme.

Ne e kemi ngritur dorën për të miratuar edhe grante me vlerë 100 mijë euro. Prandaj kjo duhet të korrigjohet.

Inshallah më mirëkuptoni!

Mimi Kodheli – Unë ju mirëkuptoj, zoti Fino, se në një ditë na është firmosur diploma e universitetit të dyve. Po nuk të mirëkuptova edhe unë, pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë besoj se këtu vjen për shkak të heqjes së taksave të KfW-së.

Ideja është (në vazhdim të asaj që tha zoti Fino), se nuk dua të bëj avokatin e djallit, por pyes pse KfW-ja dhe jo një organizëm tjetër? Ne dimë plot raste. Diku nuk lejohet që një strukturë të mos përjashtohet nga taksa. Pra, duhet të ketë shpjegime më shteruese nga ana e ministrisë, lidhur me këtë procedurë. Në qoftë se ne të gjithë këtu, i kërkojmë ministrit të Financave sot të heqë taksën për një subjekt, është luftë me shumë të drejtë, sepse disiplina financiare, po e diskutonim edhe më parë, është ajo që duhet të prevalojë mbi gjithçka që po diskutojmë këtu. Thënë kjo, e kam në parim, në përgjithësi, jo për rastin e KfW-së, do të na ndihmonte shumë dhe e kemi kërkuar disa herë këtë gjë dhe ju jo domosdoshmërisht na jeni përgjigjur (flas në përgjithësi për ministritë, jo vetëm për ju), që të mund të kemi shpjegime më shteruese dhe më të detajuara në lidhje me suksesin e këtyre granteve. Të na sillni raporte, relacione, shpjegime për suksesin që pritet të ketë nga ardhja e këtij granti, ndërkohë nuk flitet asnjëherë për mossauesin e deritanishëm, nëse ka një të tillë, se qëllon që kanë gjithmonë suksese, apo për problematikën që del bazuar në marrëdhënien e mëparshme, që një organizëm i rëndësishëm, siç është KfW-ja ka me grantet, apo pse jo, edhe me kredinë e butë që mund të ketë dhënë me paratë që kanë hyrë në ekonominë shqiptare, jo vetëm në rastin e Ministrisë së Bujqësisë, por edhe në rastet e ministrive të tjera, në mënyrë që të bëhet më e qartë për ne, pse ky grant pranohet të jetë në këtë sektor apo në ndonjë sektor tjetër, pse ky sektor ka më shumë suksese dhe pse kjo është më e nevojshme.

Sigurisht, vendimmarrja është e qeverisë, por për aq kohë sa vjen në parlament, edhe parlamenti ka nevojë të informohet për këtë gjë, me qëllim që të mos lindin keqkuptime më pas në diskutimet që ne bëjmë.

Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zonja kryetare!

Në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit e diskutuam dhe kërkuam më shumë informacion në lidhje me vitet e kaluara, për me numrin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që kanë marrë kredi, cili ka qenë impakti për të pasur një pasqyrë të qartë se sa veta mund të përfitojnë nga ky fond prej 5 milionë eurosh dhe çfarë impakti do të ketë ai. Besoj se kjo marrëveshje që do të kalojmë sot në komision, merr një rëndësi të veçantë dhe ka një përgjegjësi më të madhe për implementim për faktin se ka zëvendësuar 2 marrëveshje të denoncuar më parë nga ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë, duke qenë se ato nuk janë realizuar.

Kështu që, tashmë përgjegjësia juaj është më e madhe, sepse po vini në parlament për ta kaluar këtë marrëveshje dhe monitorimi nga ne dhe impakti i matshëm i saj, do të jetë në fakt edhe çelësi i suksesit.

Sugjerimi im është përsëri që të informohen sa më shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme për të aplikuar në këtë fond dhe për të marrë kredi për të zhvilluar agroturizmin apo për zhvillimin ekonomik të tyre, duke siguruar edhe më shumë punësim dhe më shumë zhvillim ekonomik në këto zona.

Në diskutimin e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese u tha se bankat e kanë këtë përgjegjësi. Sigurisht, në momentin që vini ju në parlament, përgjegjësia kryesore është juaja se si do t'i monitoroni dhe, se si këto para do të përthithen nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të zhvilluar agroturizmin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Unë besoj se *deadline*-n t'a vini vetë për të sjellë këtu një informacion më të zgjeruar për atë që folëm. Silleni këtu informacionin që edhe miratimi në seancë plenare, të jetë më i thjeshtë për ne.

Urdhëroni!

Ilir Halilaj – Në lidhje me informacionin për këtë financim, pra për këtë grant, ne jemi bazuar në aktualitetin e grantit të mëparshëm prej 3 milionë eurosh që në fakt ka rezultuar me kreditimin e rreth 1000 ndërmarrjeve. Këtë informacion ne mund t'jua shpërndajmë pas mbledhjes të gjithë anëtarëve të komisionit për ta pasur si referencë për efektshmërinë e një instrumenti të tillë financiar. Ky si instrument kalon ndërmjet sektorit financiar, pra kriteret

i përcakton sektori financiar i kreditimit. Instrumenti i jep likuiditetin që i duhet sektorit financiar për të arritur ato nivele kreditimi.

Në lidhje me taksat, kjo çështje është diskutuar edhe me Ministrinë e Financave dhe sipas angazhimit, sot në mëngjes do të bëjmë edhe modifikimet e relacionit për të përfshirë në mënyrë shteruese të gjitha taksat që nënkuptohen në këtë marrëveshje, por mënyra e të shprehurit në marrëveshje është diktuar nga pala gjermane, që nënkupton taksat ekzistuese, por edhe taksa të tjera që mund të vendosen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ajo është grant. Po të ishte grant dhe të mos kishte zero shpenzim për shtetin shqiptar projektligji nuk vjen fare në parlament që të diskutohet. Duke qenë se ka, sepse KfW-ja përjashtohet nga taksat, çështjet e kostove, ajo vjen këtu.

Me shumë të drejtë zoti Fino thotë: cilat taksa? Taksat janë shumë. Ato nominohen, pavarësisht se thuhet të gjitha.

Me të drejtë parlamenti nesër miraton një taksë tjetër, atëherë çfarë do të thotë, që KfW-ja do të përjashtohet? Pse vetëm KfW-ja dhe të tjerët jo? Këtu ka shumë që kanë pretenduar, për shkak të investimit që kanë bërë, parave që kanë sjellë, granteve që kanë falur, por jo domosdoshmërisht janë përjashtuar nga taksat.

Ne marrim vendimin si parlament, për të ndodhur kjo gjë, shkaqet se përse, i di ministria respektive.

Zotë zëvendësministër, keni ndonjë koment?

Ilir Halilaj – Për taksat, siç e thashë edhe më parë marrëveshja është artikuluar në këtë formë me këmbënguljen e palës gjermane dhe është pranuar nga ne për marrjen e këtij granti. Vetë ky grant nuk është subjekt i taksave në mënyrën sesi kanalizohet ose si përdoren fondet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli - Jo, të lutem, është subjekt sepse, në qoftë se granti ka të bëjë, sill makinerinë.

Ilir Halilaj – Jo, në fakt granti nuk përkthehet në...

Mimi Kodheli – Në çfarë përkthehet granti?

Ilir Halilaj – Përkthehet në injektim të sektorit financiar, në financim të institucioneve bankare ose të mikrokredie, për kreditimin e mëtejshëm, për garantimin e kredive të tyre në fushën e bujqësisë. Pra, shërben si garanci për kreditim. Si financim nuk është subjekt taksash ekzistuese sipas legjislacionit.

Mimi Kodheli – Pra, ata hyjnë garant për mikrokreditimin që fermerët do të kërkojnë pranë bankave të nivelit të dytë. Jam e saktë?

Ilir Halilaj – Po. në rast se fermeri nuk e paguan kredinë që merr nga bankat e nivelit të dytë...

Mimi Kodheli – Risku është i KfW-së.

Ilir Halilaj – ...atëherë ky fond i kalon bankës.

Mimi Kodheli – Po pra, risku është i KfW-së.

Ilir Halilaj – Po.

Mimi Kodheli – Kaq?

Ilir Halilaj – Kjo është.

Mimi Kodheli – Në rregull! Dakord!

Ilir Halilaj – Pra, nuk është subjekt taksash në momentin e hyrjes së këtij financimi në sektorin bankar.

Mimi Kodheli – Atëherë, përse duhej të ishte subjekt tatim-taksash? Në qoftë se është injektim, përse duhej të ishte subjekt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përse duhej të ishte subjekt i tatim-taksave, në këtë rast? Pse duhej të ishte subjekt?

Ilir Halilaj – Jo, nuk është, në fakt. Nuk është subjekt taksash në formën ekzistuese të financimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Në rregull! Atëherë përse marrëveshja vjen të ratifikohet në parlament? Pyetje më bazike. Sepse, shiko, ka dy arsye pse vjen. E para është gjithmonë financiare. Ka apo nuk ka? Ose është subjekt ose nuk është subjekt.

Bashkim Fino – Ky thotë se nuk ka nevojë. Po përse e kemi firmosur? Kush e ka firmosur marrëveshjen? Për këshillin e Ministrave ka një firmë këtu, por s'ka emër. A mund ta kush e ka firmosur? A mund ta di, sa për kulturë demokratike, se kush e ka firmosur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministri Niko Peleshi.

Pra, Niko Peleshi ka firmosur një marrëveshje, ku thuhet: “Neni 3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi i parë”.

Do t'jua lexoj nenin 2, paragrafi i parë, ku detajohen taksat:

“Tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksa-tatime të ngjashme indirekte.”

Çfarë do të thotë kjo: “si dhe taksa-tatime të ngjashme indirekte”?

Jo more jo, po nise të nominosh tatimin mbi vlerën e shtuar, duhet t’i nominosh të gjitha llojet e taksave. Taksat që janë të veçanta merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. në qoftë se këtu është bërë një gabim, një gabim që Niko nuk e ka parë, por edhe nëse e ka parë ka bërë gabim, e njerëzit edhe gabojnë kur punojnë. Kjo nuk do të thotë se në relacionin e projektligjit, që kanë sjellë këta, të na sjellin po prapë të njëjtën gjë. Sepse unë s’jam duke e votuar këtë gjë, se s’jam budalla që të votoj një gjë të tillë, e t’u them: ju jeni të përjashtuar nga të gjitha llojet e taksave, kurdo që të vini.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Unë jam gati ta ngre dorën për 5-milionëshin e për të gjitha taksat e nominuar: një, dy, tre, katër, pesë, sa të duan ata, sa të dojë KfW-ja; gjashtë taksa, shtatë taksa të përjashtuara, që të mos i paguajnë, por të paguajë qeveria dhe ministria përkatëse, dakord jam, e ngre dorën. Këtë jam duke thënë. Po ju ndihmoj duke thënë se në relacionin që keni bërë, që e keni bërë gabim, keni kopjuar nenin 3, a ka mundësi t’i sillni parlamentit, Komisionit të Jashtëm, Komisionit të Ligjeve, komisionit përgjegjës, listimin e taksave, prej të cilat doni ta përjashtoni KfW-në, që të mos paguajë? Në këtë rast jemi dakord. Nëse e sillni këtë gjë, e përfshijmë këtu, te materialet, të arkivohet te Gramoz Ruçi, kur votohet projektligji votohet me gjithë relacionin, zonja kryetare. Pra, në momentin që votohet me gjithë relacionin, ne si deputetë kemi të drejtë të bëjmë një kontroll. Erdhi 5-milionëshi, nga cilat taksa është përjashtuar KfW-ja, sepse po ta kem unë relacionin, atë relacion që i dërgohet Kryetarit të Kuvendit dhe më pas dërgohet në arkiv, e marr dhe e lexoj dhe më pas them: ti ke përjashtim nga taksat, 1, 2, 3, 4 dhe 5 dhe po të gjej ndonjë përjashtim tjetër, atëherë mban përgjegjësi ministria përkatëse, kaq po ju them. Ky thotë: “Jo, e kam lënë kështu, sepse ju mund të vini ndonjë taksë tjetër në 2019-ën dhe ta kem brenda edhe këtë gjë”.

Mimi Kodheli – Zoti Fino, jam plotësisht dakord me komentin tuaj, por ne nuk jemi komision përgjegjës, megjithatë ne do ta miratojmë projektligjin dhe do t’ia transmetojmë komisionit respektiv përgjegjës me këtë koment dhe me këtë kusht: “Në qoftë se listomi i taksave nga të cilat përjashtohet KfW-ja nuk vjen deri në seancën parlamentare, ne nuk do ta kalojmë projektligjin”. A jeni dakord? Po.

Bashkim Fino – Jo, ne do ta kalojmë në parim...

Mimi Kodheli – Shumë mirë me këtë kusht...

Bashkim Fino - ... dhe e votojmë sot këtu, sepse nuk jemi për të mos e kaluar...

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Në relacion patjetër që është shoqërues, sepse dy nene ka...

Bashkim Fino – Nga mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, unë ia shpjegova zëvendësministrit, nuk e njoh fare, dhe deri tani në Komisionin e Jashtëm, kanë kaluar vetëm 2-3 orë, ky ka evoluar në mendim. Në vend që të thotë se po do ta sjell një relacion, do t'i shkruaj të gjitha taksat që do të përjashtohet KfW-ja, ai thotë jo, do ta lë kështu, sepse duhen dy gjela për të kaluar ujin, se po të vijë ndonjë taksë tjetër, ta kem në rregull me këtë relacion që kam bërë. Po për budallenj na merr? Mos na fyej inteligjencën.

Ilir Halilaj – Në relacion patjetër që do të jetë e detajuar...

Bashkim Fino – Unë përveçse jam ekonomist, po ashtu Mimi dhe Bushati që marrim vesh nga këto gjëra pasi na ka lidhur puna, këta të tjerët janë juristë dhe nuk i ka lidhur puna me taksat, mos na fyej inteligjencën. Ti thua po e lë këtë nen për vitin tjetër, sepse mund të vihet një taksë tjetër. Po e ku di ti që na paragjykon se çfarë takse do të vëmë ne në 2019-ën? Ne nuk mund të vëmë asnjë taksë, por mund të vëmë, por edhe po vumë kjo nuk do të thotë se ky përjashtohet nga taksat në vitin 2019 apo në vitin 2020, sepse është absurde. Kjo ishte arsyeja që u revoltova...

(Diskutime pa mikrofon)

Andrea Marto – Këtë marrëveshje qeveritare e ka firmosur ministri në emër të qeverisë, por çfarë do të thotë zëvendësministri?

Bashkim Fino - Zëvendësministri të thotë këtë gjë...

Mimi Kodheli – Zëvendësministri të bëjë detajimet.

Bashkim Fino – Ta korrigjojë një paragraf dhe të thotë...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo të marrëveshjes...

Votoje, por unë jam kundër, unë nuk mund të shkel mbi veten time. Unë po i jap zgjidhje, kurse ti thua jo, nuk po i jep zgjidhje.

Ilir Halilaj – Zgjidhja është që ajo që thotë zoti Fino, ta shtojmë në relacionin përfundimtar.

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin Bushati – Në qoftë se ka dashur të bëjë më të mirën, por ai mund të ketë bërë edhe gabim...

Mimi Kodheli – Të vijë me marrëveshjen tjetër...

Ilir Halilaj – Do të shtohet në relacion ajo, u gjet zgjidhja.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Halilaj – A mund të bëj një koment të fundit, sepse angazhimin për relacionin ne e morëm, pra do t'i bashkëngjisim listën shteruese të taksave në të cilën marrëveshja parashtrohet. Meraku është që nuk mund ta modifikojmë marrëveshjen...

Mimi Kodheli – Relacioni është bashkëngjitur me marrëveshjen, kështu që ka të njëjtën vlefshmëri ligjore në momentin që ne e miratojmë, ashtu siç e ka edhe vetë marrëveshja.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim projektligjin në votim në tërësi? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano